

SË BASHKU PËR SHËNDET

QËNDRONI NË ANËN E SHKENCËS

7 Prilli - Dita Botërore e Shëndetit 2026

“Së bashku për shëndet. Qëndroni në anën e shkencës”

Dita Botërore e Shëndetit, që tradicionalisht shënohet më 7 Prill, në vitin 2026 dërgon një mesazh të fortë global dhe një thirrje për mbështetje të shkencës. Në këtë kontekst tema e këtij viti, e përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), është: **“Së bashku për shëndet. Qëndroni në anën e shkencës”**, duke shënuar kështu fillimin e një fushate njëvjeçare që synon të nxjerrë në pah rëndësinë e bashkëpunimit shkencor për mbrojtjen e shëndetit dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve. Konkretisht, fokusi është vënë në konceptin e **“Një Shëndet (One Health)”** - një qasje e integruar që e thekson lidhjen e ngushtë midis njerëzve, kafshëve, bimëve dhe planetit, duke theksuar se shëndeti buron nga sisteme komplekse dhe të varura në mënyrë të ndërsjellë. Iniciativa e bashkon komunitetin global rreth mesazhit kryesor se shëndeti nuk mund të mbrohet pa shkencë, bashkëpunim dhe vendime të bazuara në dëshmi. Në këtë drejtim OBSH-ja u bën thirrje qeverive, shkencëtarëve, punonjësve shëndetësorë, partnerëve dhe publikut të gjerë që të qëndrojnë në anën e shkencës duke i përdorur dhe duke i respektuar dëshmitë, faktet dhe udhëzimet e bazuara në shkencë për mbrojtjen e shëndetit, për rivendosjen e besimit në shkencë dhe shëndetin publik dhe për mbështetjen e zgjidhjeve të bazuara në shkencë për një të ardhme më të shëndetshme.

Shëndeti i njeriut, i kafshëve dhe i ekosistemit janë të lidhura në mënyrë të pandashme. Në botë rreth 60% e sëmundjeve infektive që janë shfaqur vitet e fundit burojnë nga kafshët. Urbanizimi, ndryshimi i klimës dhe degradimi i ekosistemeve krijojnë rreziqe të reja për përhapjen e tyre. Kjo tregon qartë se sfidat e shëndetit të njeriut nuk mund të adresohen në mënyrë të izoluar, por kërkojnë një qasje të koordinuar dhe multisektoriale që bashkon shëndetësinë, veterinarinë, mjedisin jetësor, bujqësinë dhe fusha të tjera.

Shkenca luan një rol qendror në këtë proces, duke mundësuar:

- zbulimin dhe monitorimin e hershëm të sëmundjeve
- zhvillimin e vaksinave dhe terapive
- përmirësimin e sigurisë së ushqimit
- mbrojtjen e mjedisit jetësor
- trajtimin e rezistencës antimikrobike

Provat shkencore kanë vlerë vetëm kur kthehen në veprime konkrete. Kjo është arsyeja pse OBSH-ja e thekson rëndësinë e partneriteteve dhe bashkëpunimit multilateral si një parakusht për politika efektive dhe zgjidhje të qëndrueshme. Pandemia e COVID-19 e theksoi edhe më shumë nevojën për një qasje kaq të integruar, duke treguar se kërcënimet globale për

shëndetin e njeriut shpesh lindin pikërisht nga bashkëveprimi midis njerëzve, kafshëve dhe mjedisit jetësor.

Koncepti One Health nënkupton parandalim më të mirë të sëmundjeve, përgatitje dhe reagim më efikas, menaxhim më të mirë të rreziqeve shëndetësore për një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme. Ai zbatohet në të gjitha nivelet, nga lokal në atë global, dhe bazohet në koordinimin, ndarjen e informacionit dhe veprimin e përbashkët.

Në vendin tonë një qasje e tillë e integruar ka një rëndësi të veçantë. Vendi përballlet me sfida të rëndësishme të shëndetit publik që lidhen me faktorët e rrezikut, siç janë stili i pashëndetshëm i jetesës, ndotja e ajrit dhe ujit, që e theksojnë lidhjen midis shëndetit dhe mjedisit jetësor.

Përmes aktiviteteve të sistemit të shëndetit publik, duke përfshirë këtu programet kombëtare të imunizimit, skringut dhe promovimit të shëndetit, po bëhen përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e shëndetit të popullatës. Të dhënat që sigurohen në sistemin e evidencave në shëndetësi dhe analizat e këtyre të dhënave në Institutin e Shëndetit Publik dhe Qendrat e Shëndetit Publik përfaqësojnë një bazë të mirë për vendimmarrje të informuar dhe për krijimin e politikave, me ç'rast përforcimi i vazhdueshëm i besimit në rekomandimet e bazuara në shkencë është qenësor për arritjen e rezultateve të qëndrueshme.

Në kohë të sfidave globale, nga sëmundjet infektive e deri te ndryshimet klimatike, secili prej nesh duhet të zgjedhë informacion të verifikuar dhe të udhëhiqet nga dëshmitë shkencore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e komunitetit.

Mesazhi për vitin 2026 është i qartë:

Shkenca funksionon kur punojmë së bashku, ndërsa shëndeti mbrohet kur veprojmë në mënyrë të informuar.

Prandaj:

Qëndroni në anën e shkencës. Zgjidhni dëshmitë. Mbështetni shëndetin për të gjithë – njerëzit, kafshët dhe planetin.

Përgatiti: Departamenti i mbrojtjes së shëndetit dhe i ndjekjes së sëmundjeve

Burime:

1. World Health Organization (WHO). *World Health Day 2026: Together for health. Stand with science*. Link: <https://www.who.int/campaigns/world-health-day/2026>
2. World Health Organization (WHO). *One Health*. Link: <https://www.who.int/health-topics/one-health>
3. World Health Organization (WHO). *One Health – Fact sheet*. Link: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/one-health>

4. Институт за јавно здравје на Република Северна Македонија. *Годишни извештаи за здравјето и здравствената заштита на населението во Република Северна Македонија*. Link: <https://iph.mk>

Mesazhet kryesore

Vendimet lidhur me shëndetin **bazoi në dëshmi**, e jo në dezinformata. Informohu nga **burime të besueshme** që:

- Ta mbrosh shëndetin tënd
- T'i parandalosh sëmundjet
- Të marrësh trajtimin e duhur

Zgjidh dëshmitë.

Beso në fakte.

Shkenca jep rezultate kur njohuritë zbatohen në praktikë.

Shëndeti fillon me informacion të saktë. Shkenca e mundëson këtë gjë.

Shkenca funksionon kur punojmë së bashku.

Shëndeti publik nënkupton ujë të pastër, vaksinim, skrining në kohë dhe miliona njerëz që jetojnë më gjatë dhe më mirë.

Mbi 150 milionë jetë të shpëtuar me vaksinim që nga viti 1974.

Nda informacion të verifikuar – nga OBSH ose nga ndonjë burim tjetër i besueshëm.

Pothuajse 59 milionë jetë të shpëtuar falë vaksinave kundër fruthit A/Inga viti 2000 deri më sot.

Përktheu: Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë